



Data: 18.05.2018

Ref.: 451/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit institucional të Kolegjit “Pjetër Budi”, për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2020.
- II. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegjit “Pjetër Budi”, të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2020:
 - Menaxhment, MA, 120 ECTS (me specializim në: 1. Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë, 2. Menaxhimi i Sigurimeve, 3. Menaxhment)
- III. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegjit “Pjetër Budi”, të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2022:
 - Doganë dhe Shpedicion, BA, 180 ECTS.
- IV. Kuotat për regjistrimin e studentëve në programet respektive, vlejné sipas vendimit të fundit të KSHC-së për ri/akreditimin të programeve studimore përkatëse.

Arsyetimi

I. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 10 Maj 2018 ka analizuar situatën e krijuar pas ndërprerjes së dinamikës së punës së AKA-së për 7 muaj dhe pasojave eventuale që mos funksionimi i AKA-së për 7 muaj (15 Shtator 2017 - 22 Prill 2018) mund ti sjellë procesit të akreditimit dhe të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Në këtë drejtim, KSHC i AKA-së me qëllim që procesi i vlerësimit dhe akreditimit të mos mbi ngarkohet dhe mos dyfishohet me rastin e fillimit të procesit të ri të akreditimit mori vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit, për periudhën një vjeçare, të akreditimit institucional dhe për gjitha programet e studimit të Kolegjit “Pjetër Budi” të cilat kanë akreditim të vlefshëm sipas vendimeve përkatëse të KSHC-së, të cekura në paragrafin I, II dhe III të këtij vendimi.


Marrë parasysh rrethanat e krijuara për arsye të mos funksionalizimit të KSHC-së të AKA-së për 7 muaj, për situatën e jashtëzakonshme të krijuar për IAL-të dhe procesin e vlerësimit dhe akreditimit, duke pasur parasysh ndeshjen e afateve ligjore për sa i përket procesit të aplikimit për ri/akreditim si dhe procesin e deklarimit të stafit akademik në përputhje me UA për Akreditim Nr. 9/2017, duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037- datë: 29.08.2011, neni 15, Pika 3, i cili përcakton se “Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Ky rishikim nga ana e ekspertëve do të përfshijë një inspektim të drejtpërdrejtë të ofrimit të shërbimeve. Riakreditimin e një institucioni apo të një ose më shumë programeve të tij mund ta kërkojnë bordi i AKA-së ose Ministria brenda një periudhe më të shkurtër se pesë vjet.”, si dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në përputhje me legjislacionin në fuqi do të monitorojë në vazhdimësi Kolegjin “Pjetër Budi” me qëllim që të sigurojë se kriteret minimale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë (Nr.9/2017, datë 02.08.2017) plotësohen në vazhdimësi për paragrafin I, II, III, IV të këtij vendimi. Në të kundërtën KSHC i AKA-së rezervon të drejtën që në njërën nga mbledhjet e radhës së KSHC-së të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi të ketë konstatuar se ky institucion nuk ka arritur të sigurojë përmbushjen e kriterëve minimale të përcaktuara në këtë UA Nr.9/2017, datë 02.08.2017.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencisë së Kosovës për Akreditim siç përcaktohet në nenin 128 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 02/L-28, në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Pjetër Budi”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

